

VENDIM
Nr.1199, datë 27.8.2008

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË
LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT
TË UJËRAVE DHE “POLAR”, SHPK, PËR BURIMIN UJOR 6/1, UJI I FTOHTË,
VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe “POLAR” sh.p.k-së, për burimin ujor 6/1, Uji i Ftohtë, Vlorë, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe këshilli i basenit ujëmbledhës, Vjosë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha